

UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES

November 15-17 | KDWW in Kosovo's Municipalities for Info Session about DACH's fairs
November 20-22 | KDWW Members meet Vocational Schools

Director's Note

Të nderuar anëtarë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare,

OEGJK këtë javë është angazhuar në mënyrë aktive në ofrimin e shërbimeve për anëtarët dhe organizimin e eventeve për të krijuar lidhje të reja me tregun gjerman.

Këtu është një përmbledhje koncize e ngjarjeve kryesore që ndikojnë në operacionet biznesore:

Dear members of the German-Kosovar Business Association,

KDWW this week has been actively engaged in providing services to members and organizing events to create new connections in the German market.

Here's a concise summary of key events impacting economic developments that influence business operations:

Business After Hours

Gjatë kësaj jave, u mbajt ngjarja Business After Hours, e mbështetur nga kompania anëtare Premium, Creative Education.

Kompanitë pjesëmarrëse patën rastin të diskutojnë dhe të shkëmbejnë përvojat e tyre, si dhe të eksplorojnë mundësitë e bashkëpunimit mes tyre.

Kjo nismë e vazhdueshme është dëshmuar të jetë një katalizator për partneritete të shumta të suksesshme.

Business After Hours





During this week, Business After Hours event was held with the support of KDWW Premium member company, Creative Education.

Participating companies embraced the opportunity to engage in fruitful discussions, share experiences, and explore collaborative opportunities among themselves.

This ongoing initiative has proven to be a catalyst for numerous successful partnerships.

Fotografi nga Business After Hours

Photos from Business After Hours



OEGJK vizitoi selinë e Shërbimit të Ekspertëve Seniorë (SES) në Bonn

Besarta Hyseni, udhëheqëse e Departamentit mbështetje dhe shërbime të anëtarëve, si dhe këshilltare për Arsim Profesional Dual ka vizituar Shërbimin e Ekspertëve Senior (SES) me seli në Bonn të Gjermanisë.

Gjatë kësaj vizite, znj. Hyseni është pritur nga znj. Ute Sonnen dhe znj. Anja Wesely nga Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar.

KDWV visited the Headquarters of Senior Expert Service (SES) in Bonn

Besarta Hyseni, Head of Market Entry & Events and advisor for Dual Vocational Education, visited the Senior Expert Service (SES) based in Bonn, Germany.

During this visit, Ms. Hyseni was received by Ms. Ute Sonnen and Ms. Anja Wesely from the International Development Department.

Në këtë vizitë është diskutuar për raportin e vitit 2022 të SES, si dhe për planet për vitin 2024.

Nga themelimi i këtij shërbimi në vitin 1983, si projekt pilot nga Dhoma Gjermane e Tregtisë dhe Industrisë, në Kosovë janë angazhuar 194 ekspertë që u kanë shërbyer kompanive vendore.

Vetëm në vitin 2022 janë realizuar 28 angazhime të ekspertëve gjermanë në Kosovë.

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare ka ekskluzivitetin e këtij shërbimi në Kosovë, mundësi nga e cila mund të përfitoni dhe të angazhoni një ekspert të dëshmuar gjerman, me një pagesë shumë të favorshme përballë ekspertizës së ofruar.

Të gjithë të interesuarit për të përfituar nga ky shërbim, mund të kontaktoni Përfaqësuesen e SES, Elena Elshani në: elena.elshani@oegjk.org

Discussions during this visit revolved around the SES 2022 annual report and the plans in place for 2024.

Since the establishment of this Service in 1983, as a pilot project by the German Chamber of Commerce and Industry, 194 experts have been assigned to Kosovo to serve local companies.

In 2022 alone, 28 assignments of German experts were realized in Kosovo.

The German-Kosovar Business Association holds the exclusivity for this service in Kosovo. Through this collaboration, you have the unique opportunity to enlist the services of a distinguished German expert at a highly favorable cost, relative to the invaluable expertise they provide.

If you are interested in benefiting from SES, you can contact the SES Representative, Elena Elshani: elena.elshani@oegjk.org



Forumet Sektoriale Vjetore për Bashkëpunim Publiko-Privat në Kosovë

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Zyrën Mbështetëse të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, ka organizuar disa Forume Sektoriale.

Forumet Sektoriale të cilat kanë filluar të mbahen këtë javë, janë të ndara në disa grupe të sektorëve në bazë të aktiviteteve ekonomike të sektorit privat.

Qëllimi kryesor i Forumeve Sektoriale është prezantimi i platformës së re për Dialogun Publiko-Privat, një platformë për debate konstruktive, ku do të adresohen sfidat me të cilat ballafaqohet sektori privat, mundësitë për bashkëpunim drejt zgjidhjes së tyre, si dhe rekomandime lidhur me mundësitë për investime dhe eksport.

Forumet Sektoriale që do të mbahen javën e ardhshme janë:

- Shërbime Financiare dhe të Sigurimeve
- Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit
- Transport, turizëm dhe Shërbime Rekreative
- Ndërtim dhe Patundshmëri
- Energji
- Miniera dhe Minerale

Annual Sectoral Forums for Public-Private Collaboration in Kosovo

The Office of the Prime Minister of the Republic of Kosovo, in collaboration with the Support Office of the National Council for Economic and Investment, has organized several Sectoral Forums.

Sectoral Forum discussions have commenced this week and are divided into several groups based on the economic activities of the private sector.

The main purpose of the Sectoral Forums is to present the new platform for Public-Private Dialogue, a platform for constructive debates addressing the challenges faced by the private sector, collaboration towards finding solutions, and recommendations regarding investment and export possibilities.

The Sectoral Forums scheduled for next week are:

- Financial and Insurance Services
- Information and Communication Technology
- Transport, Tourism, and Recreational Services
- Construction and Real Estate
- Energy
- Mining and Minerals

Peticion që arsimi të futet në Ligjin për Sponsorizim

Në përpjekje për të përgatitur rininë e Kosovës për epokën dixhitale, akterët e sektorit të teknologjisë në vend po i kërkojnë Qeverisë të ndryshojë Ligjin e Sponsorizimit.

Ndryshimi i propozuar do ta bënte arsimin të pranueshëm për sponsorizime, duke ofruar një zbritje prej 50% për sponsorët.

Petition for education to be included in the Sponsorship Law

In an effort to prepare the youth of Kosovo for the digital age, the actors of the technology sector in the country are asking the Government to change the Sponsorship Law.

The proposed change would make education eligible for sponsorships, offering a 50% discount to sponsors.

Kjo nismë synon të tërheqë investime në arsim, duke u fokusuar në edukimin dixhital dhe trajnimin teknologjik

This initiative aims to attract investment in education, focusing on digital education and technology training

Komuniteti i teknologjisë beson se ky hap është jetik për të siguruar që të rinjtë e Kosovës të lulëzojnë në peizazhin dixhital që ndryshon me shpejtësi. Bashkohuni me lëvizjen për transformim arsimor në Kosovë duke nënshkruar peticionin [KËTU](#).

The tech community believes this step is vital to ensure Kosovo's youth thrive in the rapidly changing digital landscape. Join the movement for educational transformation in Kosovo by signing the petition [HERE](#).



GRETA KAZIA
LEAD IMPLEMENTER

ISO 9001:2015
Quality Management System

ISO 14001: 2015
Environmental Management System

ISO 45001:2018
Occupational Health and Safety Management

Rritni Biznesin Tuaj me ISO Standardet

OEGJK-KDWV përveç këshillimit ligjor, pakove për investitorë gjermanë, hapjes së degës/firmës në Gjermani, shërbimeve për market entry në Kosovë e Gjermani, këshillimit për eksport, tashmë ofron dhe:

Implementimin e ISO Standardeve:

ISO 9001:2015 - Quality Management System
ISO 14001: 2015 - Environmental Management System
ISO 45001:2018 - Occupational Health and Safety Management,

Elevate Your Business with ISO Standards

OEGJK-KDWV, in addition to legal counseling, packages for German investors, opening branches/companies in Germany, market entry services in Kosovo and Germany, export advice, now also offers:

Implementation of ISO Standards:

ISO 9001:2015 - Quality Management System
ISO 14001:2015 - Environmental Management System
ISO 45001:2018 - Occupational Health and Safety Management,

Që janë të rëndësishme në veçanti për kompanitë eksportuese!

Which are particularly important for export companies!

Nëse jeni të interesuar të përfitoni nga Lead Implementer për ISO Standarde, kontaktoni Greta Kazia, në: greta.kazia@oegjk.org

Schedule an appointment with our colleague Greta Kazia, who is certified as a Lead Implementer for ISO: greta.kazia@oegjk.org

Mundësi bashkëpunimi me OJQ TOKA në projektin e Ditës së Solidaritetit

Collaboration opportunity with NGO TOKA in the Solidarity Day project

Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë se partneri ynë [OJQ TOKA](#) ka hapur thirrjen për të gjitha bizneset/ organizatat të cilat dëshirojnë të bashkohen në projektin e Ditës së Solidaritetit 2024.

We are pleased to inform you that our partner [NGO TOKA](#) has opened a call for all businesses/ organizations interested in joining the Solidarity Day project 2024.

Për më shumë informata rreth Ditës së Solidaritetit ju ftojmë të lexoni këtë [artikull](#).

For more information about Solidarity Day, we invite you to read this [article](#).

Nëse jeni të hapur për t'u bashkuar në këtë projekt që në thelb ka përkrahjen e kauzave për të mirë të komunitetit, ju ftojmë të plotësoni këtë [formular](#).

If you are open to joining this project, which fundamentally supports community causes, we invite you to complete this [FORM](#).

Për pyetje shtesë apo paqartësi, ju lutemi të kontaktoni kontaktoni: nuhi@toka-ks.org

For additional questions or clarifications, please contact: nuhi@toka-ks.org



KDWW-OEGJK

Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

NEWSLETTER | November 10th, 2023

YOUR CONTACT PERSONS AT KDWW

BOOK YOUR APPOINTMENT AT KDWW-OEGJK:

ICON Tower, 9th Floor, "Bekim Fehmiu" Str., no. 110; 10000 Prishtina

Monday - Friday | 8.30 - 16.30



Greta Kazia

HR, Përgjegjëse për
Financa dhe Anëtarësi

HR, Responsible for
Finance and Membership

greta.kazia@oegjk.org



Besarta Hyseni

Udhëheqëse e
Departamentit mbështetje
dhe shërbime të anëtarëve
Këshilltare për Arsim
Profesional Dual

Head of Market Entry &
Events
Advisor for VET

besarta.hyseni@oegjk.org



Elena Elshani

Asistente Ekzekutive
Përfaqësuese për
Shërbimin e Ekspertëve
Seniorë (SES)

Executive Assistant
Senior Expert Service
Representative (SES)

elena.elshani@oegjk.org



Gonxhe Abazi

Udhëheqëse e
Departamentit për
Marrëdhënie Qeveritare
dhe Avokim

Head of Department for
Advocacy and
Government Relations

gonxhe.abazi@oegjk.org



Eriola Muhaxhiri

Këshilltare Ligjore

Legal Advisor

eriola.muhaxhiri@oegjk.org